



**VENDIM**

**Nr. 28 Datë 02.04.2010**

**PËR**

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA”  
SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR  
TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9, dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “P”, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.04.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k për liçensim në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

**Dhe Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

## **Vendosi:**

1. Liçensimin e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike për një afat 5 vjeçar.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



- 
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**  
**Bujar Nepravishta**

---

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”10  
963  
Tirane  
69 590  
E-mail [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)